



# USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 22 (827720)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 28 Maj 2021

## Stërvitja "Defender Europe 2021"



**Ambasadorja Yuri Kim: "Kur aleatët e NATO-s bashkëpunojnë ata janë dominues në ajër, tokë apo det"**

Trupat amerikane dhe shqiptare, pjesë e stërvitjes "Defender Europe 2021" kanë ekspozuar pajisjet dhe forcën para qytetarëve të Vlorës në "Lungomare", ditën e premte, më 21 maj 2021. Aktiviteti, "Dita e Hapur", u ndoq edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim,

Ambasadori Britanik Duncan, por edhe përfaqësues të vendeve të tjera aleate të NATO. Ministri i Mbrojtjes Peleshi në përgjigje të interesimit të medias së pranishme sqaroi se: "Kjo ditë e hapur kishte për mision jo vetëm të sillte pranë publikut Stërvitjen "Defender 21", por edhe të sillte pranë jetës... >>> faqe 2

## Krenari, emocion dhe fantazi

### "Defender Europë 21": Dita e Hapur "zbret" në sheshe



>>> faqe 6-7

# "Defender Europe 2021" - Dita e Hapur në Tiranë

## Ambasadorja Yuri Kim: Kjo është piketë referimi për bashkëpunimin SHBA-Shqipëri në mbrojtje

"Defender Europe 21" hap një rrugë të re entuziazmuere për një bashkëpunim më të madh strategjik >>> faqe 3



## Takimi

### Ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim në Bazën Ajrore Kuçovë

Ambasadorja amerikane Yuri Kim vizitoi më 21 maj, Bazën Ajrore në Kuçovë, ku u takua me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Begaj dhe Gjeneral Brigade të Amerikës, Wanda Williams (Gjenerale Komanduese, nga Komanda e 7-të e Misionit Mbështetës), të cilët mbajtën seanca informuese dhe ushtrime demonstruese. Më pas, Ambasadorja Kim ndoqi ushtrimin...



>>> faqe 2

### Ministri Peleshi dhe ambasadorja Yuri Kim në Bizë

### Aty ku stërviten trupat ushtarake amerikane dhe shqiptare

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shoqëruar edhe nga ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim kanë marrë pjesë më 20 maj 2021, në një nga stërvitjet e trupave ushtarake amerikane dhe shqiptare në Bizë ku ishin të pranishëm edhe gjeneralmajor Jim Eifert (Garda Kombëtare e Floridës) dhe Brigadieri Jo Chestnutt (Mbretëria e Bashkuar). Trupat e Security Force Assistance... >>> faqe 4



Sekretari i Përgjithshëm viziton Portugalinë

### Bashkëpunimi NATO-BE, përparësi e presidencës të vendit

>>> faqe 10

### NË BAZËN E KUÇOVËS

### Shqipëria do të marrë helikopterë Blac Hawk brenda vitit 2023

faqe 5

### NGA SHQIPËRIA DHE KOSOVA

### Dy pilote ushtarake që bashkojnë SHBA dhe Shqipërinë në "Defender 2021"

faqe 5

# Stërvitja “Defender Europe 2021”

## Ambasadorja Yuri Kim: “Kur aleatët e NATO-s bashkëpunojnë ata janë dominues në ajër, tokë apo det”

*“Defender 21” është në fakt stërvitja më e madhe ushtarake, që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore*

Grupat amerikane dhe shqiptare, pjesë e stërvitjes “Defender Europe 2021” kanë ekspozuar pajisjet dhe forcën para qytetarëve të Vlorës në “Lungomare”, ditën e premte, më 21 maj 2021. Aktiviteti, “Dita e Hapur”, u ndoq edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim, Ambasadori Britanik Duncan, por edhe përfaqësues të vendeve të tjera aleate të NATO.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi në përgjigje të interesimit të medias së pranishme sqaroi se: “Kjo ditë e hapur kishte për mision jo vetëm të sillte pranë publikut Stërvitjen “Defender 21”, por edhe të sillte pranë jetës civile, jetën ushtarake, sepse në fund të fundit misioni i FA-së është të sigurojë paqe, stabilitet për qytetarët, të sigurojë gjithashtu mbrojtjen civile.

“Sot i kemi parë pajisjet, kemi parë forcat e ndryshme, kontingjentin tonë, efektivët tanë që po punojnë përkrah forcave amerikane, po shkëmbejnë eksperiencë po marrin eksperiencë dhe për këtë jemi shumë të lumtur dhe shumë krenarë. Përsëritës gjithashtu qytetarët e Vlorës, të gjithë ish - ushtarakët që na kanë shoqëruar, shoqatën e tyre. Nuk është një ditë për ambasadorët apo personalitetet, por është një ditë për qytetarët, të cilët kanë mundësi të shohin nga afër se kush është ushtria shqiptare, se çfarë synon stërvitja “Defender 21”, cilat janë kapacitetet tona dhe në fund fare të marrë një shije të mirë dhe të jetë krenar që është shqiptar”, - u shpreh ministri Peleshi.

Nga ana e saj, ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se prioritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbeten demokracia, mbrojtja dhe biznesi. “Tani jemi duke hyrë në një periudhë domethënëse të gjithë këtyre zhvillimeve. “Defender 21” është në fakt stërvitja më e madhe ushtarake, që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Do të thotë që me mijëra trupa nga SHBA, por edhe aleatë të tjerë të NATO-s, disa prej të cilëve janë të përfaqësuar edhe këtu sot, po tregojnë një rritje të aftësive tona për të bashkëpunuar së bashku si aleatë ushtarakë”, u shpreh ambasadorja Yuri Kim.

Teksa përmendi bazat që ajo bashkë me ministrin Peleshi kanë vizituar në kuadër të kësaj stërvitjeje, diplomatja Yuri Kim theksoi se: “Kur aleatët e NATO-s bashkëpunojnë me njëri - tjetrin ata janë dominues qoftë në ajër, në tokë apo në det. Së bashku më këtë zhvillim historik në Mbrojtje kemi parë që ka zhvillime të mëdha të biznesit në një front tjetër, që do të thotë zhvillime të mëdha nga ana e biznesit amerikan në fushën e energjisë”.

Ndërkohë Ambasadorja Ameri-



kane Kim, Ambasadori Britanik Duncan, Ministri Shqiptar i Mbrojtjes Peleshi, Gjenerali Shqiptar Begaj dhe Kryetari i Bashkisë Leli, vizituan Qendrën e Bashkëpunimit Ushtarak Civil në Vlorë. Në Pashaliman, ata u informuan mbi planet e stërvitjes “Defender Europe 21” të cilat përfshijnë bazën detare. Ata gjithashtu ndoqën ushtarët shqiptarë dhe amerikanë gjatë trajnimeve stërvitore për operacionet e përbashkëta logjistike nga deti në breg. “Defender Europe 21” është krijuar për t’u siguruar që forcat amerikane dhe forcat pjesëmarrëse të NATO-s të jenë trajnuar, të aftë për të vepruar së bashku dhe të gatshëm për t’u përgjigjur çdo kërcënim nga çdo drejtim.

## Ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim në Bazën Ajrore Kuçovë

Ambasadorja amerikane Yuri Kim vizitoi më 21 maj, Bazën Ajrore në Kuçovë, ku u takua me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Begaj dhe Gjeneral Brigadë të Amerikës, Wanda Williams (Gjenerale Komanduese, nga Komanda e 7-të e Misionit Mbështetës), të cilët mbajtën seanca informuese dhe ushtrime demonstruese. Më pas, Ambasadorja Kim ndoqi ushtrimin e sistemit për mbrojtjen ajrore me raketa nga Arteria e Mbrojtjes Ajrore dhe funksionimin e zonës së mbështetjes logjistike si pjesë e “Defender Europe 21”. Ambasadorja u takua me ushtarë amerikanë dhe shqiptarë, si dhe civilë shqiptarë të punësuar për të mbështetur aktivitetet stërvitore dhe i la mbresa se sa mirë ata po punojnë së bashku për të forcuar aftësitë dhe ndërveprimin midis tyre. “Defender Europe 21” është krijuar për t’u siguruar që forcat amerikane dhe forcat pjesëmarrëse të NATO-s të jenë trajnuar, të aftë për të vepruar së bashku dhe të gatshëm për t’u përgjigjur çdo kërcënim. Kjo aftësi është thelbësore për të shfaqur forcën në çdo moment dhe për të mbështetur aleancën. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bajram Begaj falënderoi ushtarakët amerikanë për praninë e tyre dhe bashkëpunimin me ushtarakët shqiptarë.



*Ambasadorja Kim ndoqi ushtrimin e sistemit për mbrojtjen ajrore me raketa nga Arteria e Mbrojtjes Ajrore dhe funksionimin e zonës së mbështetjes logjistike si pjesë e “Defender Europe 21”.*

# “Defender Europe 2021” - Dita e Hapur në Tiranë

## Ambasadorja Yuri Kim: Kjo është piketë referimi për bashkëpunimin SHBA-Shqipëri në mbrojtje

“Defender Europe 21” hap një rrugë të re entuziazmuese për një bashkëpunim më të madh strategjik

Pas turit në disa qytete, si Durres dhe Vlorë, Dita e Hapur e stërvitjes “Defender Europe 21” është ndaluar ditën e dielë, më 23 maj 2021, në Tiranë. Qytetarët patën mundësi të shohin nga afër, në sheshin “Nënë Tereza” helikopterët Black Hawk, mjetet e blinduara dhe demonstrime të ndryshme të efektivëve amerikanë e shqiptarë.

Pas ekzekutimit të dy himneve, atij shqiptar dhe amerikan, fjalën e hapjes e mori shefi i Përgjithshëm i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj. Ai shprehu angazhimin e ushtarakëve shqiptarë për t’u gjendur pranë qytetarëve në çdo situatë. Ai siguroi dhe aleatët e NATO-s se Forcat e Armatosura janë të gatshme të qëndrojnë krah për krah me aleatët në çdo angazhim. “Mirënjohje për aleatin tonë strategjik SHBA, i garantoj ata dhe të gjithë aleatët e NATO-s se ushtarakët shqiptarë do të jenë të gatshëm për çdo angazhim dhe çdo mision sa herë të kërkohet nga aleatët dhe Aleanca dhe të autorizohet nga autoritetet e vendit. Ne do të jemi garantë me besën dhe besnikërinë e shqiptarit, me vullnetin dhe profesionalizmin ushtarak për të qëndruar krah për krah me kolegët tanë amerikanë dhe të Aleancës dhe në situata më të vështira”, - deklaroi gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u bëri thirrje të rinjve që të shohin Forcat e Armatosura si një “mundësi të artë” për karrierë. Ministri Peleshi tha se “Defender 21” ka qenë mundësia më e madhe edhe për të testuar kapacitetet ushtarake të vendit tonë.

“Sot është një ditë e hapur e stërvitjes Defender 21, më e madhe e zhvilluar në dekadën e fundit në Ballkanin Perëndimor. Sot e kemi sjellë këtë stërvitje në zemër të Shqipërisë në zemër të Tiranës, për ta sjellë atë para qytetarëve e për të treguar përmasën civile që e gjithë përpjekja jonë ushtarake ka, si Shqipëri, si aleate e NATO dhe përkrah SHBA. Kjo përpjekje ka për qëllim të mbajë paqen, të forcojë demokracinë, të na bëjë të flemë të qetë e të jemi më të sigurt për të ardhmen. U kemi dhënë sot mundësi qytetarëve që ta prekin me dorë se çfarë do të thotë të jesh krenar që je shqiptar. Pas 12 vitesh anëtarësi në NATO, sot ka qenë mundësia më e madhe e historisë tonë për të testuar veten dhe kapacitetin tonë. U bëj ftesë të rinjve ta shohin në karrierën e tyre si një mundësi të artë pjesëmarrjen pranë Forcave të Armatosura”, - tha z. Peleshi.

Ambasadorja amerikane Yuri Kim nënvizoi se marrëdhënia e Shqipërisë me SHBA-në do të jetë mbi çdo gjë. “Si miq dhe aleatë, ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë në krah të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në Afganistan, në Irak dhe më gjerë. Dhe e dimë nga ato përvoja që Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria.

“Defender 21” hap një rrugë të re entuziazmuese për një bashkëpunim më të madh strategjik. Kjo rrugë do të mundësojë që ushtarët amerikanë të kthehen në Shqipëri për t’u stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se sukcesi i “Defender 21” pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.” - u shpreh diplomatja Yuri Kim.

Teksa vlerësoi ushtarakët dhe përgëzoi ambasadorin e SHBA-së për kontributin dhe përkushtimin në forcimin e kapaciteteve në mbrojtje dhe në drejtësi, kryeministri Edi Rama deklaroi se misioni tjetër i përbashkët mes Shqipërisë dhe SHBA-së do të jetë rritja e kapaciteteve njerëzore të Forcave të Armatosura.

“Besimi që SHBA-të kanë treguar në vijim tek ky partneritet dhe tek kjo aleancë e madhe strategjike me Shq-



ipërinë e vogël kulmon me këtë stërvitje ushtarake. “Defender Europe 21”, e cila jo rastësisht është stërvitja më e madhe, me përfshirjen më domethënëse që ka ndodhur ndonjëherë në historinë e rajonit tonë. Kam shumë besim, dhe bazuar në besimet me gjeneralët, që na nderuan me praninë e tyre me hapjen e kësaj stërvitjeje, por dhe me bashkëbisedimin e vazhdueshëm me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara, se ne do të mund të hedhim hapa të tjerë kuptimplotë në rritjen e cilësisë së burimeve njerëzore të Forcave tona të Armatosura, duke krijuar kështu një hapësirë shumë më tërheqëse edhe për ta materializuar atë thirrje që bëri ministri i Mbrojtjes për të rinjtë, të cilët gjithnjë e më shumë do ta shohin adresën e forcave të Armatosura si një mundësi të artë për formimin dhe për jetën e tyre pas shkollimit”, - deklaroi kryeministri. Z. Rama theksoi se krijimi në Shqipëri i një kapaciteti të ri akademik në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore të Forcave tona të Armatosura, në partneritet me SHBA-të, është objektiv dhe misioni i përbashkët i qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara

këtu në vendin tonë.

Presidenti Ilir Meta tha se operacionet e trupave shqiptare me ato amerikane kanë qenë të suksesshme dhe janë realizuar të gjithë objektivat.

“Mbështetja dhe shkëmbimi i eksperiencave mes forcave tona dhe forcave të Amerikës do t’i shërbejë rritjes së kapaciteteve tona mbrojtëse në të ardhmen. Shpreh falënderimet më të përzemërta për kontributin dhe mbështetjen e SHBA-së dhe vendeve të tjera që zgjodhën vendin tonë si vend pritës për organizimin e kësaj stërvitje të rëndësishme. Si një vend anëtar i NATO-s ne jemi një vend mjaft i vlerësuar për këtë fakt. NATO është aleanca më e madhe e lirisë dhe besimi i popullit shqiptar dhe mbështetja ndaj saj është unanime ashtu sikundër edhe vokacioni ynë evropian”, - nënvizoi z. Meta.

“Defender Europe 21” është stërvitja më e madhe ushtarake që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Rreth 28 mijë mijë trupa nga SHBA-të, por edhe nga vendet e tjera, aleate të NATO-s, po demonstrojnë një rritje të aftësive ushtarake për të bashkëpunuar si aleatë ushtarakë.

### Gjendemi në një moment të rëndësishëm në histori

## Fjala e Ambasadores Yuri Kim në ‘Ditën e Hapur’ të Stërvitjes Ushtarake “Defender 2021”

Çfarë dite e bukur për të ekspozuar ushtritë tona dhe Stërvitjen “Defender Europe 2021”, e cila është stërvitja më e madhe ushtarake e udhëhequr nga SHBA, që Ballkani Perëndimor ka parë ndonjëherë! Kjo është piketë referimi për bashkëpunimin SHBA-Shqipëri në mbrojtje. Është gjithashtu një moment historik referimi për Aleancën e NATO-s. Kjo Stërvitje është në zhvillimin e sipër dhe po merr trajtën e një sukcesi të madh. “Defender 21” ka qenë një sukses ushtarak.

Në javët e fundit, ushtarë nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Kosova, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Rumania, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara janë stërvitur së bashku për të forcuar gatishmërinë, aftësitë dhe ndërveprueshmërinë tonë në mënyrë që Aleatët dhe Partnerët e NATO-s të mund të kryejnë çdo mision në tokë, përtej detit dhe në ajër.

Gatishmëria, aftësitë dhe ndërveprueshmëria jonë garantojnë parandalimin e konfliktit, ruajtjen e paqes dhe mbajtjen e kombeve tona të sigurta. Për më tepër, “Defender 21” ka hedhur bazat për një bashkëpunim edhe më të fortë në vitet në vazhdim. Kam patur mundësinë të vizitoj shumë nga vendet e trajnimit në Shqipëri. Në çdo vendndodhje, gjëja e parë që shoh është shqiptarë dhe amerikanë, që punojnë së bashku dhe që po njihen me njëri-tjetrin. Marrëdhëniet profesionale dhe



vetjake që po formohen tani e tejkalojnë trajnimin ushtarak, ato forcojnë lidhjet tona. Ushtarët tanë në uniformë ndihen saktësisht sikurse ndihemi ne diplomatët, të veshur me kostume, për këtë vend: Ata mrekullohen me bukurinë e Shqipërisë, vlerësojnë mikpritjen e ngrohtë të popullit shqiptar dhe janë krenarë që Shtetet e Bashkuara e quajnë Shqipërinë një mik dhe Aleat. Si miq dhe aleatë, ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë në

krah të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në Afganistan, në Irak dhe më gjerë, dhe e dimë nga ato përvoja që Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria.

Ne e vlerësojmë që pavarësisht nga dallimet që mund t’i ndajnë njerëzit kohë pas kohe, ju e pranoi që gjendemi në një moment të rëndësishëm në histori dhe të gjithë jeni të bashkuar në marrëveshjen tuaj me ne të gjithë, mbi vlerën dhe

rëndësinë e një marrëdhënieje edhe më të fortë midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, midis amerikanëve dhe shqiptarëve.

“Defender 21” vjen ndërsa festojmë 30 vjetorin e përfundimit të diktaturës komuniste, fillimin e demokracisë në Shqipëri dhe rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Vjen gjithashtu njëqind vite pasi Shtetet e Bashkuara qëndruan me ju në kërkesën tuaj të drejtë për një Shqipëri të pavarur. Ne qëndrojmë me ju sot, në mbështetje dhe solidaritet të fortë për një Shqipëri demokratike, të pavarur, të fortë. Do të vazhdojmë të qëndrojmë me ju ndërsa ndërmerri detyrat e vështira, tashmë të nevojshme, për të arritur potencialin e plotë të Shqipërisë. Këto detyra janë të vështira por nuk janë të pamundura. Edhe nëse do ishin të pamundura, nëse dikush mund të sfidojë vështirësitë, ai është populli shqiptar. Ju e keni bërë këtë herë pas here përgjatë historisë, dhe më duhet të them se jam vërtetë e prekur që jam këtu, në Shqipëri, dhe të shoh drejt sheshit Skënderbej, statujën e heroit tuaj, i cili duhet të jetë një hero për të gjithë ne si një simbol i bashkimit, këmbënguljes dhe vizionit. Jam krenarë që jam sot këtu me ju, jemi krenarë që jemi me ju si aleatë këtu sot, nesër, krah për krah, përgjithmonë.

Tiranë, 23 maj 2021

## Ministri Peleshi dhe ambasadorja Yuri Kim në Bizë

# Aty ku stërviten trupat ushtarake amerikane dhe shqiptare

*Trupat e Security Force Assistance Brigades (SFAB) dhe ato të Batalionit të Dytë të Këmbësisë: qitje me mortaja, snajper, veprimet e skuadrës në sulm, goditje objekti dhe rënia në pritë*

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shoqëruar edhe nga ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim kanë marrë pjesë më 20 maj 2021, në një nga stërvitjet e trupave ushtarake amerikane dhe shqiptare në Bizë ku ishin të pranishëm edhe gjeneralmajor Jim Eifert (Garda Kombëtare e Floridës) dhe Brigadieri Jo Chestnutt (Mbretëria e Bashkuar).

Trupat e Security Force Assistance Brigades (SFAB) dhe ato të Batalionit të Dytë të Këmbësisë kryen një sërë demonstrimesh, në kuadër të stërvitjes së "Defender Europe 2021", e cila u ndoq nga të pranishmit. Qitje me mortaja, snajper, veprimet e skuadrës në sulm, goditje objekti dhe rënia në pritë, ishin disa nga demonstrimet e efektivëve. Në përfundim të stërvitjes Ministri i Mbrojtjes u shpreh efektivëve shqiptarë të angazhuar në Bizë përgëzimet e tij, të kryeministrit Edi Rama, por edhe të popullit shqiptar për përfaqësimin dinjitoz të Forcave të Armatosura



të Shqipërisë në këtë stërvitje të rëndësishme.

"Jemi shumë krenarë për punën që bëni këtu. Ju jeni me fat që në këtë kohë po zhvillojmë një nga stërvitjet më të mëdha të rajonit, jo vetëm të Shqipërisë. Jemi duke bërë një integrim shumë dinjitoz me kolegët amerikanë dhe kjo na bën që të krijojmë më shumë besim në vete, të testojmë kapacitetet tona. Po e tregoni çdo ditë që ne e justifikojmë të qenit një vend anëtar i NATO-s edhe me standardet", - u shpreh ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. "Defender Europe 2021" po zhvillohet në 7 baza të ndryshme të Shqipërisë dhe do të vijojë deri në mesin e muajit qershor.

## Edhe Kosova pjesë e stërvitjes "Defender Europe 21"

Edhe në Kosovë po zhvillohet këto ditë stërvitja ushtarake "Defender 21 Europe" nën drejtimin e ushtrisë amerikane. Përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës thonë se kjo është mundësi historike për vendin, meqë për herë të parë Kosova është ndër vendet nikoqire të stërvitjes së këtij niveli. Stërvitja që po zhvillohet edhe në disa zona të qytetit të Gjakovës, është e rëndësishme historike për Kosovën, tha koloneli nga Forca e Sigurisë së Kosovës, Ejup Maqedonci.

"Për Kosovën ka rëndësi të veçantë sidomos për faktin se për së pari herë Kosova pret një ushtrim të nivelit të tillë në territorin e saj. Sa për sqarim ushtrimi "Defender 21" është ushtrim që drejtohet nga ushtria e Shteteve të Bashkuara për Evropë dhe Afrikë dhe qëllim kryesor ka rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet SHBA-ve dhe vendeve partnere si dhe ngritjen e gatishmërisë operacionale", tha ai.

Koloneli Maqedonci thotë se përveç rritjes së bashkërendimit me partnerët, synimi kryesor i kësaj stërvitjeje në Kosovë është edhe vlerësimi i kapaciteteve të para të këmbësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Majori amerikan, Kyle Pernell, i cili ndodhet për herë të parë në Kosovë, ka detyrën e vëzhgimit të mbarëvajtjes së ushtrimeve për të dhënë në fund vlerësimin mbi kom-



paninë e parë e këmbësisë.

Ai tha se është shumë i kënaqur me punën e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke shprehur bindjen se kjo Forcë është në rrugë të mbarë për anëtarësim në NATO.

"Kurrë nuk kam punuar me një forcë tjetër të tillë profesionale që me të vërtetë dëshiron të bëhet më e mirë për çdo ditë, pjesëtarët e së cilës janë vërtetë të ngazëlyer kur dalin në punë dhe të bëjnë krejt çka është e nevojshme

për të arritur të jenë më të mirët në fushën e tyre. Besoj 100 për qind se jemi duke ecur në atë drejtim me çfarë po shohim çdo ditë përgjatë gjithë trajnimit dhe çfarë po shohim ne si ekip i kombinuar gjatë procesit të vlerësimit, mendoj se po krijohen kushtet tash në mënyrë që synimi për anëtarësim në NATO të plotësohet", tha ai.

Koloneli Maqedonci, thotë se në këtë proces, si edhe në vet ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është i pazëvendësueshëm.

"Ne kemi një plan afatgjatë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për bashkëpunim. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kontribuar posaçërisht në shkollimin, edukimindhe trajnimin e pjesëtarëve tanë si në SHBA edhe këtu. Gjithashtu kemi edhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Gardën Kombëtare të Ioëas e cila ka ndihmuar në vazhdimësi në ruajtjen dhe krijimin e partneritetit ndërmjet nesh", tha ai.

Nënkoloneli i FSK-së, Albert Kuçi, shpjegon veprimtaritë kryesore të kësaj stërvitjeje. "Operacionet kryesore të cilat janë planifikuar të realizohen gjatë kësaj kohe, janë operacione sulmuese, operacione mbrojtëse dhe operacione

të stabilitetit. Kryesisht janë operacione luftarake ku simulohen situata të ndryshme për të mundësuar trajnimin e njëjësive tona në operacione sulmuese, mbrojtëse dhe të stabilitetit. Cikli i trajnimit, përgatitjet dhe planifikimi kanë filluar shumë më herët, pra ne kemi filluar me trajnimin e kësaj kompanie në muajin janar 2020", thotë ai.

Ushtarja, Dafina Zhinipotoku, është pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës që nga vitit 2019, dhe për herë të parë merr pjesë në një stërvitje të tillë. "Një ditë e zakonshme është zgjimi në ora gjashtë në mëngjes, pastaj fillojmë me aktivitete të ndryshme deri kur mbarojmë në ora 22:00 në mbrëmje. Normalisht është pak sfiduese si për të gjithë ushtarët por pas çdo vështirësie prap gjejmë forcën të vazhdojmë përpara dhe është një përvojë shumë e mirë", thotë ajo. Defender Europe 21, është stërvitja më e madhe ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore. Këtë vit stërvitja shtrihet në tri zona kryesore, në rejonin e Baltikut, në rajonin Detit të Zi dhe në atë të Ballkanit Perëndimor. Në të marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 27 vende të ndryshme, ndërsa 16 vende janë pritëse, ndër to këtë vit edhe Shqipëria edhe Kosova.

# Në bazën e Kuçovës janë vendosur raketahedhëset "Patriot"

## Shqipëria do të marrë helikopterë Black Hawk brenda vitit 2023

*Deklaroi kreu i Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen  
në Ambasadën e SHBA-së, nënkolonel Erol Munir*



*"Aktualisht nuk kemi asnjë plan për të ndërtuar baza të NATO-s në Shqipëri, por së fundmi kemi pasur vizitën e tre gjeneralëve të rëndësishëm në Shqipëri, një prej të cilëve Gjenerali Tod D. Wolters, komandanti i forcave amerikane të vendosura në Europë, gjithashtu gjeneralët e tjerë të cilët bënë një vlerësim të infrastrukturës së Shqipërisë. Do të shikojmë bazat që janë të vendosura në Shqipëri për të pasur në vëmendje nëse mund të kemi investim në të ardhmen, por aktualisht nuk kemi ndonjë plan konkret përveç bazës që kemi në Kuçovë, e cila do të fillojë punimet së shpejti këtë vit," - u shpreh Munir.*

**A**ktualisht NATO nuk ka plane konkrete për të ndërtuar një tjetër bazë ushtarake në Shqipëri përveç bazës ajrore të Kuçovës, ndërkohë që qeveria shqiptare pritet të marrë brenda vitit 2023 helikopterë "Black Hawk" si pjesë e shtimit të kapaciteteve ushtarake.

Këtë e tha kreu i Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen në Ambasadën e SHBA-së, Erol Munir. Duke komentuar stërvitjen "Defender Europe 2021", të cilën Munir e cilësoi si "jashtëzakonisht të suksesshme", ai tha se vitet e fundit Shqipërinë e kanë vizituar disa gjeneralë të rëndësishëm të NATO-s për të shqyrtuar mundësinë për investime.

"Aktualisht nuk kemi asnjë plan për të ndërtuar baza të NATO-s në Shqipëri, por së fundmi kemi pasur vizitën e tre gjeneralëve të rëndësishëm në Shqipëri, një prej të cilëve Gjenerali Tod D. Wolters, komandanti i forcave amerikane të vendosura në Europë, gjithashtu gjeneralët e tjerë të cilët bënë një vlerësim të infrastrukturës së Shqipërisë. Do të shikojmë bazat që janë të vendosura në Shqipëri për të pasur në vëmendje nëse mund të kemi investim në të ardhmen, por aktualisht nuk kemi ndonjë plan konkret përveç bazës që kemi në Kuçovë, e cila do të fillojë punimet së shpejti këtë vit," - u shpreh Munir.

Zyrtari amerikan tha se në bazën e Kuçovës tashmë janë vendosur raketahedhëset "Patriot", të cilat janë fjala e fundit e teknologjisë së sigurisë ushtarake.

Munir tregoi se në stërvitjen "Defender 21" morën pjesë forca nga 26 vende të ndryshme të botës, të cilat erdhën në Shqipëri me armatime të ndryshme detare, tokësore dhe ajrore. Ai tha se 12 helikopterë "Black Hawk" ishin pjesë e stërvitjes dhe më tej njoftoi se së shpejti helikopterë të tillë do të ketë edhe Shqipëria. "Shqipëria do të marrë dy helikopterë Black Hawk në vitin 2023," - tha Munir.

"Do të vazhdojmë të ndihmojmë forcat e armatosura shqiptare për të shtuar kapacitetet e tyre dhe kjo nuk do të ndalojë për kohën që do të vijojë," - shtoi zyrtari amerikan. Kreu i Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen në Ambasadën e SHBA-së tha se Shqipëria u zgjodh për stërvitjen ushtarake të NATO-s prej gjeografisë, pozicionit gjeostrategjik, prej faktit se është "pro-amerikan" dhe ka kapacitetin për pritjen e forcave. Munir tha se plani i forcave të Aleancës së Atlantikut të Veriut është që të jetë gati për ato që mund të ndodhin në situata, apo kriza të caktuara të Europës. Pjesëmarrës në stërvitje ishin edhe një grup prej Forcave të Sigurisë së Kosovës, për të cilët Munir tha se ishte i lumtur për bashkëpunimin e tyre. Zyrtari amerikan tha se stërvitja "Defender Europe 2021" është vetëm fillimi dhe se pritet që në vazhdim ushtarë nga SHBA do të vijojnë të vijnë në Shqipëri për t'u stërvitur.

NGA SHQIPËRIA DHE KOSOVA

## Dy pilote ushtarake që bashkojnë SHBA dhe Shqipërinë në "Defender 2021"

*Ato janë pilote Valdete Mehanja e cila ka lindur në Kosovë dhe tani sherben në Regjimentin e Aviacionit 1-131, në Gardën Kombëtare të Alabamës dhe Armela Murati nga Shqipëria që po ndjek kursin e pilotës për helikopterët ushtarakë në Farkë*

**A**mbasada e SHBA-së në Tiranë ka zgjedhur si foto të ditës, Togeren Valdeta Mehanja nga Garda Kombëtare e Alabamës e lindur në Kosovë dhe Togeren e 2-të Armela Murati, në aerodromin e Farkës në Shqipëri. "Njihuni me të "parat" të cilat po bëjnë hapa përpara drejt barazisë. Togerja e 2-të Valdeta Mehanja (majtas), pilote helikopteri me Regjimentin e Aviacionit 1-131 nga Garda Kombëtare e Alabamës dhe shqiptare e lindur në Kosovë, bisedoi mbi ngjashmëritë midis tyre me piloten e helikopterit të parë shqiptare femër, Togeren e 2-të Armela Murati, në aerodromin e Farkës në Shqipëri, ndërsa marrin pjesë së bashku në "Defender Europe 21", shprehet ambasada, duke sqaruar rolin e "Defender-Europe 21". Shprehet ambasada amerikane në Tiranë.

"Defender-Europe 21" është një ushtrim i përbashkët vjetor, shumëkombësh, i udhëhequr nga ushtria amerikane në shkallë të gjerë, i krijuar për të krijuar gatishmërinë dhe ndërveprimin midis ushtrive të SHBA, NATO dhe partnerëve.

Ky takim emocionues, më pas ka gjetur vend më 25 maj edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes. Në të thuhet se: "Valdete Mehanja dhe Armela Murati janë dy pilotet që duket i kanë dhënë kuptimin e vërtetë qëllimit të stërvitjes më të rëndësishme që zhvillohet



në Evropë, "Defender 2021", ndërveprimi me aleatëve të NATO-s. Nëntoger Valdeta Mehanja ka lindur në Kosovë, por prej vitesh ajo është pilote helikopteri me Regjimentin e Aviacionit 1-131, në Gardën Kombëtare të Alabamës. Ajo ka ardhur në Shqipëri si pjesë e trupave amerikane që po marrin pjesë në stërvitjen "Defender '21". Në Bazën Ajrore të Farkës ajo është takuar me të vetmen vajzë të kursit të pilotit për helikopterët ushtarakë, nëntoger Armela Muratin. Armela i është bashkuar prej një viti Forcave të Armatosura shqiptare dhe thotë se

ka zgjedhur rastësisht këtë kurs, pasi u emërua në Forcën Ajrore.

Të dyja vajzat kanë ndarë mes tyre sekretet e profesionit, por edhe kanë bashkuar ambicien për të qenë të barabarta mes burrash në këtë profesion.

Nëntoger Mehanja thotë se për të ishte befasia të vinte në Shqipëri si ushtarë amerikane, pasi nuk kishte qenë asnjëherë më parë. E pyetur përse kishte zgjedhur t'i bashkohej ushtrisë amerikane, ajo ka një arsye të fortë: "I jam bashkuar ushtrisë amerikane, sepse kjo ushtri, veçanërisht Amerika e ka ndihmuar shumë popullin shqiptar, sidomos Kosovën. Dhe e ndiej veten si në borxh". Nëntoger Mehanja thotë se më herët ka qenë pilote civile.

Ndërsa nëntoger Armela Murati, tekta dëgjon nga kolegja amerikane këshillat në gjuhën shqipe, thotë se ka marrë mbështetje dhe kurajë në një mjedis ku mbizotërojnë burrat. "Nuk kisha synim të bëhesha pilote. Thjesht doja t'i shërbeja vendit tim, fati deshi që unë t'i bashkohem Forcës Ajrore dhe tashmë jam edhe kursante. Presioni është goxha i madh, por unë kam ardhur me synime të qarta dhe dua që këtë hap që kam hedhur ta çoj deri në fund", shprehet nëntoger Murati. E këtë ambicie të vajzës së re nga Shqipëria e inkurajon nëntoger Valdeta Mehanja, e cila ka kaluar 11 vjet për të arritur deri këtu. "Mos u dorëzo, se gjithçka ia vlen!", shprehet shqiptarja nga Kosova që përfaqëson SHBA në "Defender 2021".

# Krenari, emocion dhe fantazi

MIMOZA GOLIKJA

## “Defender Europë 21”: Dita e Hapur “zbret” në sheshe

*Qendra Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura pjesë “Ditëve të Hapura”*

“Dita e Hapur-Open Day”, organizimet e ditëve të hapura të Forcave të Armatosura kishin për qëllim të tregojnë se si FA punojnë për paqen dhe sigurinë, ato shënojnë për të pranishmit krenari, emocion dhe fantazi. Në këto ditë të gjithë janë të mirëpritur të kenë një vështrim dhe të marrin një informacion të veçantë pranë standave dhe prezantimit të forcës ushtarake. Dita e hapur ka të bëjë me lidhjen e shërbimeve publike me komunitetin dhe gjithashtu për të treguar ekspertizën e ushtarëve para publikut dhe vlerësimin e tij për FA. Paraqitja para publikut të gjerë është një platformë e gjetur për të mësuar më shumë rreth FA. Njerëzit e të gjitha moshave dhe të të gjitha profesioneve e shtresave të popullsisë kuptojnë nëpërmjet “Open day”, betejat dhe sakrificat e personelit ushtarak në mbrojtjen e vendit, në mbrojtje të jetës dhe të paqes.

Pjesë e “Ditëve të Hapura” për publikun e gjërë, ka qënë edhe prezantimi i Qendrës Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura ku kanë paraqitur interes pikturat e fëmijëve të ushtarakëve, grupi i këngës apo ekspozija dokumentave historike dhe objekteve muzeale historike, etj. Prezentë pranë këtij “pavioni” në natyrë kanë qënë në Tiranë, ambasadorja amerikane Yuri Kim, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, qytetarë të shumtë të pranishëm të cilët janë entuziazmuar nga grupi i këngëtarëve, por sidomos nga pikturat e piktorëve të vegjël Arber Zerani, Juena Tahiri, Krisjana Myzyri, Ester Spaho, Ema Kenuti, Suada Suti, Sabjan Mehmetaj, Eluisa Sadiku, Ajsel Karaj, Diona dhe Adea Hitoaliaj, Prisea Lleshi, Arli dhe Noel Hazizi, Ledia dhe Tea Cako etj.

\*\*\*

Skenari i ditëve të hapura të stërvitjes “Defender Europë 21”, hartuar me shumë kujdes, ishte një aktiviteti tepër i madh dhe i hapur për publikun (si vetë emri) që mblodhi mijëra pjesëmarrës në sheshet e qyteteve, Durrës, Vlorë, Tiranë dhe Kuçovë. Aktivitete dhe prezantime ushtarake të ndryshme të forcës të tokës, detit dhe të ajrit, stenda që shfaqën aftësitë e Forcave të Armatosura para vizitorëve të shumtë, emocion, kuriozitet dhe solidaritet. Ditët e hapura të “Defender Europë 21”, zgjedhur si një “mjet” për të shkuar pranë komunitetit, gjithashtu shërbeu si një “program arsimor për civilët”, një program, ku ne gazetaret vërejtëm një ndërgjegjësim të shtuar për FA. Dita e hapur zgjeron kuptimin e publikut për punën që kryhet në FA dhe rolin e ushtrisë në jetën civile, i tregon “pajisjet e fundit”, popullsisë civile që po mbron, nderon dhe vlerëson pjesëmarrësit e FA dhe pse jo fton të rinjtë për t’u bërë edhe pjesë e tyre. Është një ditë gjithashtu e mundësisë, e kujtesës dhe dhënies të homazheve të veçanta burrave dhe grave që shërbejnë në FA, të gjithë individëve që janë në shërbim të vendit të tyre, na kujton nevojën e vazhdueshme për unitet në FA, si dhe midis të gjithë qytetarëve tanë në interes të sigurisë dhe paqes. Publiku mëson më shumë rreth asaj që FA bën në vend dhe në të gjithë botën dhe tregon mbështetjen e tij për Forcat e Armatosura shqiptare që mbrojnë vendin



dhe interesat e tij dhe që janë pjesëmarrës në misionet e NATO-s, duke promovuar paqen, duke dhënë ndihmë dhe trajnim, duke siguruar mbrojtjen dhe luftuar terrorizmin. Dita e Hapur e “DE 21” një festë e hapur për komunitetin, një stacion i periudhës stërvitore 1 maj -14 qershor 2021.

### Durrësi hap siparin e Ditës së Hapur “Defender Europë 21”

Qyteti i lashtë bregdetar i Durrësit, ishte ai që hapi siparin e “Ditëve të Hapura” të stërvitjes “Defender Europë 21”, ashtu si një muaj më parë, (4 maj 2021), kur nën një ceremoni madhështore priti “Ditën e Vizitorëve të Shquar” në portin e tij, që ishte Porta-hyrëse e stërvitjes “Defender 21”. Porti i Durrësit, promovoi rëndësinë gjeo-strategjike të vendi tonë si dhe rëndësinë strategjike të tij, me infrastrukturën e nevojshme për zbatim të trupave ushtarake. Durrësi priti aktivitetin e parë të open day-it të parë të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe 21”, në sheshin “Iliria”. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj, mori pjesë në këtë aktivitet të zhvilluar në Durrës dhe përshëndeti nga afër nën një organizim të shkëlqyer qytetarët durrsakë dhe jo vetëm. Kryetarja e Bashkisë së Durrësit, znj. Ani Sako, prefekti i Qarkut Durrës, z. Roland Nasto, ushtarakë të lartë dhe qytetarë e nxënës shkollash të qytetit, gjithashtu ishin pjesëmarrësit e “Ditës të Hapur”, të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe 21”. Gjeneralmajor Begaj tha se “publiku ynë është njohur nga media me atë çka po ndodh në fushën ushtarake në Shqipëri” dhe duke folur mbi “demonstrimin dhe vullnetin e aftësisë të aleatit tonë strategjik dhe Aleancës për sigurinë dhe mbrojtjen kolektive”, ai iu drejtua të rinjve dhe rejave të shumtë

të pranishëm në këtë event, “të cilët përjetojnë më shumë se kushdo, emocione dhe ndjesi të veçanta kur shikojnë një bashkëpunim dhe ndërveprim kaq të ngushtë të forcave tona me ato amerikane”. Gjenerali vuri theksin te vlerat e veçanta që ka shërbimi në FA sidomos sot, kur jemi pjesë e NATO-s dhe kemi në krah aleatë të mëdhenj.

### Stërvitja “Defender ‘21” ekspozon aftësitë në Vlorë



Vlora e bregdetit por edhe Vlora e Flamurit, qyteti shqiptar “i pavarësisë” kishte një zgjim ndryshe mëngjesin e datës 21 maj 2021. Trupat amerikane dhe shqiptare, pjesë e stërvitjes “Defender Europe 2021”, “pushtuan” sheshin qendror të “Lungomares” vlonjate ndërsa rezet e diellit derdeshin pa kursim në det atë mëngjes. Pajisjet dhe forca ushtarake aleate ekspozoheshin para qytetarëve të Vlorës në “Lungomare”. Qindra e qindra

qytetarë të moshave të ndryshme, gjyshër e nipër dhe prindër, apo ish pjesëmarrës të FA u bënë pjesëmarrës të Ditës të Hapur në qytet. Buqëqeshje dhe emocione pa fund krahe forcave të armatorave shqiptare dhe aleate u fiksuan në mijëra shkrepje fotografish, nga të rinjtë dhe jo vetëm, nën një recital të vazhdueshëm të marsheve ushtarake të vendeve aleate dhënë nga Orkestara Frymore e FA. Aktiviteti u ndoq edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj, ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, por edhe përfaqësues të vendeve të tjera aleate të NATO. “Kjo ditë e hapur kishte për mision jo vetëm të sillte pranë publikut Stërvitjen “Defender ‘21”, por edhe të sillte pranë jetës civile, jetën ushtarake, sepse në fund të fundit misioni i FA është të sigurojë paqe, stabilitet për qytetarët, të sigurojë gjithashtu mbrojtjen civile”, tha ministri i Mbrojtjes Peleshi. “Sot i kemi parë pajisjet, kemi parë forcat e ndryshme, kontingjentin tonë, efektivet tanë që po punojnë përkrah forcave amerikane, po shkëmbejnë eksperiencë po marrin eksperiencë dhe për këtë jemi shumë të lumtur dhe shumë krenarë”, tha ai. “Nuk është një ditë për ambasadorët apo personalitetet, por është një ditë për qytetarët, të cilët kanë mundësi të shohin nga afër se kush është ushtria shqiptare, se çfarë synon stërvitja “Defender 21”, cilat janë kapacitetet tona dhe në fund fare të marrë një shije të mirë dhe të jetë krenar që është shqiptar”, tha ministri Peleshi.

Ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se prioritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbeten demokracia, mbrojtja dhe biznesi. “Tani jemi duke hyrë në një periudhë domethënëse të gjithë këtyre zhvillimeve. “Defender 21” është në fakt stërvitja më e madhe ushtarake, që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore”, tha ajo duke shtuar se bashkëpunimi i bën aleatët e NATO-s “dominues qoftë në ajër, në tokë apo në det”.





### "Defender Europe 21" zbret në sheshin "Nënë Tereza"

Tirana, metropoli, frymëmarrja dhe kryeqyteti shqiptar, do t'u dhuronte qytetarëve të vet një të dielë ndryshe, një prezantim madhështor dhe një festim të pazakontë ushtarak, si ai i datës 23 maj 2021. Pas udhëtimit në disa qytete, stërvitja "Defender Europe 21" zbriti në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë. Helikopterët "Black Hawk", mjetet e blinduara dhe demonstrime të ndryshme të efektivëve amerikanë e shqiptarë do të ngjallnin kuriozitet dhe interes të madh për të pranishmit. Pas ekzekutimit të dy himneve, atij shqiptar dhe amerikan, autoritetet pjesëmarrës nënvizuan mirënjohje për aleatin strategjik, SHBA. "Ushtarakët shqiptarë do të jenë të gatshëm për çdo angazhim dhe çdo mision sa herë të kërkohet nga aleatët dhe Aleanca dhe të autorizohet nga autoritetet e vendit. Ne do të jemi garantë me besën dhe besnikërinë e shqiptarit, me vullnetin dhe profesionalizmin ushtarak për të qëndruar krahas për krahas me kolegët tanë amerikanë dhe të Aleancës dhe në situata më të vështira", premtoi në fjalën e tij të hapjes gjeneralmajor Bajram Begaj. FA një "mundësi e artë" për karrierë, nënvizoi ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi kur u bëri thirrje të rinjve që të shohin FA si një mundësi punësimi. "U kemi dhënë sot mundësi qytetarëve që ta prekin me dorë se çfarë do të thotë të jesh krenar që je shqiptar. Pas 12 vitesh anëtarësi në NATO, sot ka qenë mundësia më e madhe e historisë tonë për të testuar veten dhe kapacitetin tonë", tha z. Peleshi.

"Në krahas të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në



Afganistan, në Irak dhe më gjerë", ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se "marrëdhënia e Shqipërisë me SHBA është mbi çdo gjë", ajo tha se ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë, "si miq dhe aleatë" dhe "Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria". "Defender 21" hap një rrugë të re entuziazmuere për një bashkëpunim më të madh strategjik. "Ushtarët amerikanë do kthehen në Shqipëri për të stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se sukcesi i "Defender 21" pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.", tha Yuri Kim. Rritja e kapaciteteve njerëzore të FA, do të jenë misioni i rradhës për shqipërinë dhe SHBA, tha



kryeministri Edi Rama kur deklaroi se "ne do të mund të hedhim hapa të tjerë kuptimplotë në rritjen e cilësisë së burimeve njerëzore të Forcave tona të Armatosura, duke krijuar kështu një hapësirë shumë më tërheqëse edhe për ta materializuar atë thirrje që bëri ministri i Mbrojtjes për të rinjtë, të cilët gjithnjë e më shumë do ta shohin adresën e FA si një mundësi të artë për formimin dhe për jetën e tyre pas shkollimit", tha kryeministri Rama.

### Performancë e "Defender 21" në Kuçovë

Kuçova, qyteti tjetër i rradhës i përzgjedhur nga stërvitja "Defender 21" për zhvillimin e Ditës të Hapur, të datës 25 maj 2021. Qyteti "i aviacionit" dhe "i naftëtarëve", qyteti i njerëzve punëtorë dhe më zemër të bardhë do të ofronte zonën pedonale të tij për të zhvilluar "Open Day-n". Trupat amerikane dhe shqiptare pjesë e stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe 2021", do të "zbarkonin", për t'i dhënë një panoramë tjetër shëtitorese së bukur



në stërvitjen "Defender 21", qytetarët e shumë shfaqën interes dhe u njohë nga afër me se çfarë ofrojnë FA. Truproja e Nderit e FA performoi për të pranishmit dhe Orkestra Frymore e FA ekzekutoi himnet kombëtare të të dy vendeve dhe ekzekutime të tjera ushtarake. As këtu nuk munguan shkrepletet e fotove para autoblivandave ushtarake apo stendave të

paraqitura nga forca tokësore, ajrore dhe detare e FA. Qyteti ofroi pjesëmarrjen dhe FA prezantimin dhe emocionin e ndërsjellë. Aktiviteti u ndoq edhe nga zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralbrigade Manushaqe Shehu, ish shefi i Shtabit të Forcave të Amatosura/deputet i zonës, Bardhyl Kollçaku, kryetari i Bashkisë së Kuçovës z. Kreshnik Hajdari, prefekti i qarkut, znj. Valbona Zylyftari, drejtorë drejtorish në SHP, përfaqësues nga Policia e Shtetit, si dhe qytetarë e nxënës shkollash të qytetit, etj.

Aktiviteti u përmbyll me një koncert të grupit artistik të fëmijëve, të cilët kishin udhëtuar nga Tirana drejt Kuçovës, ku kënga "Globi rrotullohet" u vazhdua me këngë të tjera, të shoqëruar me alternime të oganizuara me kujdes, nga këngëtarë të njohur të QKMBMMFA Kozma Dushi, Redon Makashi, Saimir Braho dhe Elton Deda.

### Emocioni që mbart Grupi Artistik i QKMBMM të FA

Ditët e Hapura të "Defender 21" shënuan një demonstrim të kombinuar nga FA të progresit të saj. Ditët e Hapura kishin një numër të stendave dhe ngjarjeve, por ato kishin gjithashtu zonën e pamunguar në evente të tilla, atë të fëmijëve të Qendrës Kulturorë të QKMBMMFA. Përfshirja e tyre në këto evente ofron kënaqësinë e vazhdimësisë të jetës që askush më mirë se sa fëmijët mëshirojnë. Ata janë të gjithë fëmijë të ushtarakëve dhe civilëve të MM dhe FA, pjesë e grupit artistik që trajnohen me një kujdes të posaçëm në QKMBMMFA nga trajnierë dhe instruktorë të veçantë siç janë këngëtarët dhe muzikantët e njohur të muzikës shqiptare, specialistë në sektorin e Aktiviteteve të Kulturës dhe Sporteve. Ky grup fëmijësh performon dhe dhuron me zërat e tyre nota të gëzueshme që sjellin emocion të veçantë njerëzor në aktivitete të tillë si Dita e Hapur, midis uniformave të ushtarakëve, pajisjeve, teknikës, armatimit, helikopterëve, paqes dhe jetës, qëllimit të mbrojtjes dhe sigurisë. Notat muzikore dhe ngjyrat që hedhin me penelat e tyre këta fëmijë në pikturat plot talent që u ekspozuan si në Tiranë dhe qytetet e tjera ku u zhvillua ky aktivitet i dhanë gjallëri të pamatë 'open day-it' dhe shtuan motivin që të jep liria dhe paqja. Punimet e fëmijëve dhe ekspozitat e tyre tregojnë dhe flasin shumë përveç kënaqësisë që të jep soditja

e tyre. Ka shumë mënyra për ta treguar këtë mbështetje dhe QKMBMMFA përveç të tjerash ka këtë grup fëmijësh të talentuar dhe të trajnuar nga instruktorët e tyre që me prezantimet e punimeve në pikturë apo me koncertin e grupit artistik të fëmijëve, të shoqëruar dhe nga këngëtarë të njohur të QKMBMM të FA, i shtojnë vlerat organizimeve kaq dinjitoze.

# Qendra e Personel Rekrutimit

## Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021*

**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistikë (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi beachelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislativitetit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënofficerëve) përveç kritereve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të



mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

### Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënofficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumen-



tacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

### Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

**Shenim:** Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularët përkatës janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjelljes përjashtimit tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.





# QPR rekruton kandidatë për studime

## Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë

*Tre bursa për mjekësi, një për oficer tokësor dhe një për oficer detar. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021*

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë, 5 (pesë) të drejta studimi si më poshtë vijon: Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Tokësore "EVELPIDON", gjitharmësh, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Detare "SND", luftëtar, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Shërbimeve (të trupës) të Forcave të Armatosura "SSAS", për degën e mjekësisë, 3 (tre) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021.

### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer shkollën e mesme ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të mesëm. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, jo më pak se 7 (shtatë). Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të mos jetë i martuar. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 60 pikë në testimin ALCPT. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkolla ushtarake. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformatojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit, kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e



studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato, kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më

sipër, s'kualifikohet.

### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shën-

detësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

### Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve:

Kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve duhet të paraqesin dëshmi penalteti, vërtetim nga gjykata, vërtetim nga prokuroria, vërtetim nga përbarimi, ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake por edhe testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

### Datat e testimit:

Ndërsa aplikanti do të kalojë katër teste në datat e përcaktuara. Kështu testi i gjuhës së huaj (anglisht) do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi fizik do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi intelektual do të zhvillohet më 24 qershor 2021 dhe testi psikologjik do të zhvillohet më 24 qershor 2021.

**Shënim:** Aplikanti duhet të deklarojë se të dhënat e paraqitura në formularët e plotësuar janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.





Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoana diskutoi rolin e NATO-s në mbrojtjen kibernetike, qasjen e saj ndaj sigurisë kibernetike dhe përgjegjësinë e Aleancës në drejtimin e inovacionit teknologjik në fjalën e tij në konferencën “Mbrojtja e ndërprerë”, më 19 maj 2021. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit më të madh midis një game të gjerë aktorësh, përfshirë fillestarët dhe qeverinë, duke theksuar se kjo është pjesë e iniciativës NATO 2030. Z. Geoana theksoi rolin vendimtar të NATO-s si një forum midis aleatëve për të shkëmbyer praktikën më të mira, jo vetëm për të promovuar përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive të mbrojtjes, por edhe për të forcuar besimin midis aleatëve. Mbulimi i trefishtë, i përbërë nga qeveria, industria dhe academia, luan një rol të rëndësishëm për të adoptuar teknologji të reja dhe për të shmangur boshllëqet e ndërveprimit, shtoi ai. Si pjesë e NATO 2030, Aleanca duhet të përshtatet dhe të përgatitet për kërcënime të paparashikueshme, përfshirë hapësirën kibernetike dhe të përqendrohet më shumë në qëndrueshmërinë dhe inovacionin, shpjegoi Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm. Teknologjitë e reja, duke përfshirë sistemet e sensorit, do të jenë thelbësore në trajnimin e ushtrisë për t'u përshtatur me bazat e reja të luftës, siç janë mjediset urbane, tha ai. Ndërsa theksoi se është e rëndësishme për të forcuar mbrojtjen kundër sulmeve kibernetike, ai shtoi se është gjithashtu e rëndësishme për të rritur qëndrueshmërinë midis shoqërive. Duke parë përpara, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë që Aleanca të ruajë avantazhin e saj teknologjik dhe nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

## Konferenca “Mbrojtja e ndërprerë”

# Aleanca duhet të përgatitet për kërcënime të paparashikueshme

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s thekson bashkëpunimin si kyç për mbrojtjen e fortë kibernetike



## NATO mbështet sovranitetin territorial të Ukrainës

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana zhvilloi bisedime më 18 maj 2021 me Zëvendës Kryeministrin e Ukrainës për Integrimin Europian dhe Euro-Atlantik, Olha Stefanishyna. Ata adresuan përpjekjet e reformës së Ukrainës dhe situatën e sigurisë në dhe përreth Ukrainës. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm përsëriti mbështetjen e palëkundur të NATO-s për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe vuri në dukje se Aleanca do të vazhdojë të monitorojë lëvizjet e trupave të Rusisë në dhe rreth Ukrainës. Z. Geoana inkurajoi Ukrainën të përdorë plotësisht kornizën e saj të partneritetit me NATO-n për të adresuar sfidat aktuale të sigurisë, për ta bërë Ukrainën më elastike dhe për të zbatuar aspiratat e saj Euro-Atlantike dhe reformat kryesore.



## Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm diskuton iniciativën NATO 2030 në Asamblenë Parlamentare të NATO-s

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoana përshkroi mundësitë e iniciativës NATO 2030 në fjalimin e tij në Asamblenë Parlamentare të NATO-s më 17 maj 2021. Duke parë përpara Samitin e NATO-s, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm e quajti atë një moment të rëndësishëm për NATO-n, duke nënvizuar nevojën për të forcuar unitetin dhe solidaritetin, përshpejtimin e adaptimit dhe përgatitjen e Aleancës për të ardhmen.

Iniciativa NATO 2030 përcakton një axhendë ambicioze e cila do të jetë në zemër të Samitit të NATO-s më 14 qershor, shpjegoi Z. Geoana. Ai përshkroi përparësitë e iniciativës, duke përfshirë nevojën për të forcuar mbrojtjen kolektive dhe të përqendrohet në qëndrueshmëri. NATO gjithashtu do të duhet të zgjerojë qasjen e saj ndaj sigurisë, shpjegoi ai, duke përfshirë adresimin e implikimeve të sigurisë së ndryshimit të klimës dhe ruajtjen e avantazhit teknologjik të NATO-s. Ai shtoi se NATO 2030 ka të bëjë gjithashtu me riafirmimin e vlerave të NATO-s dhe ruajtjen e rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e një lidhjeje të fortë transatlantike për të përmbushur së bashku sfidat e së nesërme, duke demonstruar solidaritetin me fjalë dhe në vepra.

## NATO dhe Algjeria forcojnë bashkëpunimin shkencor

17 maji 2021 shënoi përmbylljen e suksesshme të aktivitetit të parë të bashkëpunimit shkencor midis NATO-s dhe Algjerisë, duke zhvilluar zgjidhje teknologjike të rëndësishme për luftën kundër terrorizmit. Ky përfaqëson një moment të rëndësishëm në angazhimin e NATO-s në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Brenda kornizës së Programit të Shkencës për Paqen dhe Sigurinë e NATO-s (SPS), ekspertë nga Algjeria, Franca dhe Suedia kanë zhvilluar teknologjinë e parë të imazheve terahertz në Afrikën e Veriut. Ky sistem skanimi do të mundësojë zbulimin e materialeve të rrezikshme, të tilla si armët e zjarrit dhe eksplozivët, dhe kështu do të ketë aplikime të mundshme në mbrojtjen e vendeve të rrezikuara nga kërcënimet terroriste. Kjo teknologji e re e imazheve terahertz u përrua në një ceremoni virtuale të prerjes së shiritit me zyrtarë të NATO-s, përfaqësues nga Algjeria, Franca dhe Suedia, si dhe grupi shumëkombësh i shkencëtarëve që drejtojnë kërkimin. Ndhimës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Sfidat e Sigurisë në Zhvillim, David van Weel dhe gjenerali Serir Aomar, Dekan i “Polytechnique Ecole Militaire” në Algjeri, morën pjesë përkatësisht nga Selia e NATO-s dhe Algjerit.

## Shefat e Mbrojtjes garantojnë përshtatshmëri ushtarake

30 shefat e Mbrojtjes të vendeve aleate të NATO-s u takuan, më 18 maj 2021, në Selinë e NATO-s për takimin e tyre të dytë në 2021. Pesë javë larg Samitit të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive në Selinë e NATO-s në Belgjikë, Shefat e mbrojtjes të vendeve aleate diskutuan për NATO 2030, Përshtatjen Strategjike Ushtarake, planifikimin dhe operacionet, misionet, aktivitetet e drejtuara nga NATO. Ata gjithashtu u takuan me shefat e Mbrojtjes të dy prej Partnerëve të Mundësisë së Përmirësuar të NATO-s, Ukrainës dhe Gjeorgjisë. Në takimin me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, Komiteti Ushtarak u informua për planet e tij për Samitin e ardhshëm dhe axhendën e tij përpara, e cila do të formojë të ardhmen e Aleancës. Takimi i dytë i ditës u përqendroi në mbështetjen ushtarake për propozimet e NATO 2030 dhe konceptet strategjike ushtarake në zhvillim, Koncepti për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euro-Atlantike dhe Konceptin Capstone të Luftimeve të NATO-s. Me tërheqjen e Misionit të Mbështetjes së Vendosur në vazhdim, Shefat e mbrojtjes të vendeve aleate shkëmbyen mendime mbi progresin dhe marrëdhëniet e ardhshme NATO-Afganistan. Misionet e drejtuara nga NATO në Irak dhe Kosovë, si dhe u informuan, mbi provën e parë të madhe të Aleancës të Strukturës së Komandës së saj të Përshtatur, Stërvitjen Steadfast Defender 21. Me pjesëmarrjen nga më shumë se 20 aleatë nga Amerika e Veriut dhe Europa, Steadfast Defender 2021 do të ndihmojë në përmirësimin, gatishmërinë dhe ndërveprimin e forcave aleate dhe




praktikimin e lëvizshmërisë ushtarake në të gjithë Europën.

Shefat e mbrojtjes të vendeve aleate mirëpritën ndryshimin e titullit nga Kryetar në Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s. Ata vunë në dukje se Forcat e Armatosura duhet të pasqyrojnë shoqëritë që mbrojnë dhe të jenë aq të ndryshme sa janë gjithëpërfshirëse.

Kryetari i Komitetit Ushtarak, Shefi i Ajrit Marshall Sir Stuart Peach deklaroi se “Zhvillimi dhe ruajtja e standardeve të larta për veten tonë është thelbësore. Vendosja e shembullit dhe inkurajimi i standardeve të larta në ushtarakët e tjerë në botë është gjithashtu e rëndësishme. Ne kemi bërë progres, dhe ndërsa mbetet shumë punë për të bërë, unë jam krenar që shoh këtë titull të ndryshuar. Gjatë takimit me Komandantin e Përgjithshëm të Ukrainës, gjeneralin Khomchak, shefat e mbrojtjes të vendeve aleate mirëpritën përparimin e vazhdueshëm të Ukrainës në reformat e mbrojtjes dhe

theksuan mbështetjen dhe këshillat e tyre praktike për Ukrainën. Aleanca po mbështet Ukrainën në fusha të tilla si komandimi dhe kontrolli, kundërveprimi me pajisjet shpërthyes dhe rehabilitimi mjekësor. Shefat e mbrojtjes të vendeve aleate shprehën vlerësimin e tyre për pjesëmarrjen e Ukrainës në Misionin e Mbështetjes së Vendosur të NATO-s dhe Misionin e Forcës së Kosovës. Pasdite, ata u takuan me homologun e tyre gjeorgjian, shefin e Mbrojtjes gjenerali Giorgio Matiashevili. Ata shfrytëzuan rastin për të falënderuar gjeneralin për mbështetjen e vazhdueshme të Gjeorgjisë për misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO. Diskutimet u përqendruan në Paketën Thelbësore të Azhurnuar NATO-Gjeorgji, e cila përmban masa dhe iniciativë që synojnë forcimin e aftësive mbrojtëse të Gjeorgjisë dhe zhvillimin e bashkëpunimit më të afërt të sigurisë dhe ndërveprimit me anëtarët e NATO-s.



Gjenerali Corell shprehu kënaqësinë që është në vizitë në Kosovë, duke vlerësuar lart sukseset e FSK-së, sidomos ato aktivitete që janë zhvilluar në kuadër të programit të bashkëpunimit me GK të Ajovës, duke shprehur gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet edhe më tej në të ardhmen. Po ashtu edhe komandanti i FSK-së gjeneralletenant Rrahman Rama priti në takim të ndarë komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (Iowa-s) nga Shtet e Bashkuara të Amerikës, gjeneral Majorin Ben Corell.



Gjeneralmajori Ben Corell në Prishtinë

# Ministri Mehaj priti komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës

*U vlerësua shumë e rëndësishme për FSK-në pjesëmarrja në stërvitjen "Defender Europe 21"*

**M**inistri i Mbrojtjes Armend Mehaj priti komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (Iowa-s) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjeneralmajorin Ben Corell. Në takim ministri Mehaj e njoftoi gjeneralin Corell mbi zhvillimet në Ministrinë të Mbrojtjes, për objektivat që ai ka parashtruar si ministër si për Ministrinë ashtu edhe për FSK-në. Ministri Mehaj vlerësoi lart bashkëpunimin e ngushtë të deritanishëm mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe FSK-së, me theks të veçantë për misionin e parë paqeruajtës jashtë vendit të FSK-së përkrah Gardës Kombëtare të Ajovës në Kuvajt. Po ashtu më këtë rast ata biseduan edhe për agjendën e zhvillimit të ushtrimit "Defender Europe 21", për rëndësinë e pjesëmarrjes së FSK-së si dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së Kosovës si shtet. Gjenerali Corell shprehu kënaqësinë që është në vizitë në Kosovë, duke vlerësuar lart sukseset e FSK-së, sidomos ato aktivitete që janë zhvilluar në kuadër të programit të bashkëpunimit me GK të Ajovës, duke shprehur gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet edhe më tej në të ardhmen. Po ashtu edhe komandanti i FSK-së gjeneralletenant Rrahman Rama priti në takim të ndarë komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (Iowa-s) nga Shtet e Bashkuara të Amerikës, gjeneral Majorin Ben Corell. Të dy gjeneralët vlerësuan lart shkallën



e bashkëpunimit mes FSK-së dhe GK të Ajovës, duke vlerësuar lart mundësinë që i ka dhënë FSK-së të jetë në mision paqeruajtës në Kuvajt, ushtrimet dhe trajnimet e përbashkëta të deritanishme. U vlerësua si shumë e rëndësishme për FSK-në pjesëmarrja në ushtrimin fushor "Defender Europe 21".

## FSK fuqizon kapacitetet operacionale taktike

**M**inistri i Mbrojtjes Armend Mehaj i shoqëruar nga Komandanti i FSK-së gjeneralletenant Rrahman Rama dhe Sekretarja e Përgjithshme Rozafa Ukimeraj, vizituan kontingjentin e ri të automjeteve taktike HMMVW të radhitura në pistën e kazermës së FSK-së "Adem Jashari". FSK po fuqizon kapacitetet e veta operacionale taktike, duke shtuar kapacitetet me pajisje të reja, të blera sipas buxhetit të planifikuar dhe Planit të Zhvillimit 10 vjeçar të FSK-së. Rritja e kapaciteteve me pajisje taktike po bëhet në harmoni me Planin Gjithëpërfshirës të Transformimit dhe ngritjeve të kapaciteteve të FSK-së për të kryer misionin e vet kushtetues. Ngritja e kapaciteteve teknike të FSK-së dita-ditës tregon se ajo po ngrihet sipas standardeve të NATO-s.

## Kompania e deminimit është aset i veçantë për sigurinë e vendit

**N**ë vazhden e vizitave në vend-operacionet e FSK-së, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj i shoqëruar nga zv.komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, inspektoi njësinë e Kompanisë së Deminimit të FSK-së e angazhuar në operacionin e deminimit në zonën e fshatit Seçisht të Hanit të Elezit. Me këtë rast, ministri Mehaj u prit nga komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, nënkolonel Shpend Zogaj dhe përmes zv.komandantit të Kompanisë së Deminimit, kapiten Beslir Hoxhaj u njoftua me misionin, detyrat, strukturën organizative, personelin, pajisjet, trajnimet, si dhe ushtrimet dhe operacionet e përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ministri Mehaj u njoftua edhe me arritjet e kompanisë si dhe shkallën e realizimit të operacionit, kushtet e operimit, kërkesat si dhe sfidat e njësisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve profesionale që ndërlihen me deminimin dhe asgjësimin e mjeteve të pashpërthyer dhe operacionit përkatës. Nga ana e tij, ministri Mehaj shprehu vlerësimin e lartë me përgëzimin për detyrën e shenjtë në shpëtimin e jetëve, rezultatet kulminante të arritura deri më tani, shkallën e lartë të profesionalizimit dhe shkathhtësive të demonstruara të pjesëtarëve të kompanisë së deminimit. Në fund, ai siguroi se në cilësi të Ministrisë të Mbrojtjes do të ofrojë të gjithë angazhimin, përkushtimin dhe mbështetjen maksimale për realizimin e suksesshëm të planit të njësisë në kuadër të operacioneve të tyre të deminimit dhe asgjësimit të mjeteve të pashpërthyer. Ai në fund theksoi se, kompania e deminimit është aset i veçantë për sigurinë e vendit, por edhe potencial i madh për angazhim në operacionet e stabilitetit në misionet ndërkombëtare. Operacionet e deminimit të FSK-së, përveç në fshatin Seçisht, në të njëjtën periudhë janë duke u realizuar edhe në tri zona tjera si në Babaj i Bokës të Gjakovës, Varosh dhe Parku i Lirisë së Ferizajit. Që nga viti 2021, specialistët e deminimit dhe EOD-së së FSK-së kanë pastruar rreth 3.260.000 m<sup>2</sup> dhe asgjësuar 9231 mjete eksplozive anëmbanë vendit, proces ky i cili planifikohet të përfundojë në vitin 2024. Në fund të vizitës ministri Mehaj i shoqëruar nga kryetari Suma dhe delegacionet e tyre vendosi buqetë me lule në kompleksin memorial në varrezat e dëshmoreve të Hanit të Elezit, në fshatin Pustënik.

REGJIMENTI I XHENIOS I GARDËS KOMBËTARE TË FSK-SË

## Ndërtohet ura "Mabey Johnson" me gjatësi prej 36 metra


**M**inistri i Mbrojtjes, Armend Mehaj i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, inspektoi urën e lëvizshme "Mabey Johnson", me gjatësi prej 36 metra, të realizuar para 3 javësh nga ana e inxhinierëve të Regjimentit të Xhenios të Gardës Kombëtare të FSK-së. Me këtë rast ai u prit nga kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, i cili falënderoi dhe shprehu mirënjohjen e lartë për këtë projekt i cili ka lehtësuar qarkullimin e automjeteve dhe qytetarëve të kësaj ane të izoluar pas dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e muajit Janar të këtij viti.



Nga ana e tij, ministri Mehaj shprehu vlerësimin e lartë për punën e shkëlqyeshme të inxhinierëve të FSK-së dhe theksoi gatishmërinë e plotë për realizimin e detyrimit kushtetues

dhe ligjor për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile dhe në shërbim maksimal ndaj qytetarëve tanë në çdo kohë dhe rrethanë. Pas inspektimit, ministri Mehaj i shoqëruar edhe nga kryetari

Lladrovci dhe delegacionet e tyre, nderoi të gjithë heronjtë e kombit duke vendosur buqeta lulesh para shtatoreve të tyre në Sheshin kryesor të qytetit në Drenas.



“Ne tashmë kemi filluar procesin e vaksinimit me vaksinat kineze që mbërritën disa javë më parë, ato janë shpërndarë, ka një sasi prej 50,000 dozash të tjera që duhet të shpërndahen dhe tani kjo do të jetë një sasi që ne do të shtojmë dhe procesi i imunizimit do të vazhdojë për grupmoshat më të larta, e më tej për të gjithë popullsinë në vendin tonë. Vakcina është e vetmja armë që kemi për të ndryshuar plotësisht imazhin e pandemisë jo vetëm në vendin tonë, por kudo në botë”.



Kina dërgon 100 mijë doza të vaksinës “Sinofarm”

# Shekerinska: Do të vazhdojë vaksinimi i Armatës dhe Ministrisë së Mbrojtjes

*Sigurimi i vaksinës “Sinofarm” u arrit pas takimit në muajin mars midis ministres Shekerinska dhe ministrit kinez të Mbrojtjes Uei Fenghe*

Në poliklinikën “Jane Sandanski” u realizua dorëzim pranimi i donacionit prej 100.000 doza vaksinash nga Armata e Republikës Popullore të Kinës për Maqedoninë e Veriut, në luftën kundër pandemisë. Donacioni u pranua nga ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, ministri i Shëndetësisë Venko Filipçe dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, gjeneral nënkolonel Vasko Gjurginovski. Donacioni pason takimin e ministres Shekerinska me ministrin kinez të Mbrojtjes Uei Fenghe në Mars të këtij viti, kur të dy ministrat ranë dakord që krizat globale, të tilla si ajo me pandeminë mund të zgjidhen vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe solidaritetit të madh reciprok.

“Kjo është një ndihmë e vërtetë në kohën e duhur dhe në një sasi që do të intensifikojë seriozisht përpjekjet tona për të luftuar pandeminë. Kjo sasi e vaksinave do të na japë një shans për të vazhduar procesin e vaksinimit të pjesëtarëve të Armatës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, por natyrisht sasia më e madhe si në rastet e mëparshme do t’i jepet nevojave të shëndetit publik dhe nevojave të qytetarëve. Në këtë mënyrë, ne do të sigurojmë një sistem funksional të mbrojtjes, mirëpo do të ofrojmë një shans shtesë në luftën kundër pandemisë që ka bashkuar tërë shoqërinë tonë dhe



që është përparësia numër një e të gjitha institucioneve tona”, -tha Shekerinska, duke falënderuar Kinën për mbështetjen e saj.  
Ministri i Shëndetësisë Venko Filipçe

tha se është një sasi e konsiderueshme e vaksinave që mund të ndryshojnë ndjeshëm pamjen e pandemisë në Maqedoninë e Veriut. “Ne tashmë kemi filluar procesin e vaksinimit me vaksinat

kineze që mbërritën disa javë më parë, ato janë shpërndarë, ka një sasi prej 50,000 dozash të tjera që duhet të shpërndahen dhe tani kjo do të jetë një sasi që ne do të shtojmë dhe procesi i imunizimit do të

vazhdojë për grupmoshat më të larta, e më tej për të gjithë popullsinë në vendin tonë. Vakcina është e vetmja armë që kemi për të ndryshuar plotësisht imazhin e pandemisë jo vetëm në vendin tonë, por kudo në botë. Unë shpreh mirënjohje të madhe, kjo konfirmon partneritetin dhe afërsinë midis dy vendeve, dy popujve dhe sinqerisht besoj se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen,” -tha Filipçe. Ambasadori i Republikës Popullore të Kinës Zhang Zhuo në një deklaratë për media tha se bota aktualisht po përjeton ndryshime të thella falë kësaj pandemie dhe të gjithë duhet t’i përmbahemi multilateralizmit dhe të forcojmë solidaritetin dhe bashkëpunimin. “Kina është e gatshme të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive popullin e Maqedonisë së Veriut në përpjekjet tuaja për të luftuar pandeminë dhe të bashkojmë duart për të shkruar një kapitull të ri në marrëdhëniet tona miqësore midis vendeve tona dhe ushtrive tona,” -tha ambasadori Zhuo.

## SHEFAT E SHTABIT TË USHTRIVE TË 30 VENDEVE ANËTARE

# Gjenerallejtënant Gjurginovski në Komitetin Ushtarak të NATO-s

*Republika e Maqedonisë Veriore merr pjesë në operacionet paqeruajtëse të NATO-s në Afganistan, KFOR, misionet e BE-së Althea në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Afrikën Qendrore*

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski, i cili ishte për një vizitë zyrtare në Bruksel, mori pjesë në seancën e rregullt të Komitetit Ushtarak të NATO-s (KP), në formatin e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm, të mbajtur në Selinë e NATO-s. Në takimin e kryesuar nga Kryetari i Forcës Ajrore, Marshalli Ajror Sir Stuart Peach, pas fjalimit të Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg, Shefat e Shtabit të Ushtrive të 30 vendeve anëtare, sipas axhendës diskutuan planifikimin dhe adaptimin ushtarak në NATO, operacionet, misionet dhe



aktivitetet e vazhdueshme të kryera nga Aleanca. Gjatë qëndrimit të tij në Bruksel, gjeneral Gjurginovski ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të Bashkimit Europian në nivelin e Shefave të Shtabit, ku nën kryesimin e Presidentit të BE-së, Gjenerali Claudio Graziano është diskutuar lidhur me Misionet dhe operacionet civile të Bashkimit Europian si pjesë e


politikës së tij të përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes.

Takimet e organeve më të larta këshillimore ushtarake të NATO-s dhe BE-së, përveç axhendave të planifikuara, janë një mundësi e shkëlqyeshme për takime të ndërsjella të burrave të lartë të Ushtrive, të cilët, përveç shkëmbimit të pikëpamjeve, forcojnë marrëdhëniet reciproke duke iniciuar aktivitetet bilaterale. Republika e Maqedonisë Veriore merr pjesë aktivisht dhe kontribuon në operacionet paqeruajtëse të NATO-s në Afganistan dhe KFOR në Kosovë, si dhe në misionet e BE-së Althea në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe EUTM RCA në Republikën e Afrikës Qendrore.



## 21 maji, dita e Divizionit të 4-të të Këmbësorisë

Në kazemat “Chede Filipovski-Dame” në Kërçovë, me një ceremoni ushtarake anëtarët e Batalionit të 4-të të Këmbësorisë (Divizioni i 4-të i Këmbësorisë) shënuan 21 majin, ditën e njesisë. Komandanti i Divizionit të 4-të të Këmbësorisë, Nënkolonel Goran Trajanoski dhe Shefi i Shtabit të Brigadës së I-rë të Këmbësorisë, Nënkolonel Goran Petrusovski kanë uruar të gjithë anëtarët e njesisë, theksuan detyrat e angazhimet aktuale si dhe aktivitetet e ardhshme të programuara. Në ceremoninë me rastin e Ditës së njesisë së batalionit, u dhanë vlerësime stimuluese për personelin që u dallua më shumë me punën e tyre në periudhën e kaluar. Në prag të ditës, u realizua një aksion i dhurimit të gjakut me të cilin stafi vullnetarisht tregoi humanitetin e tij duke dhuruar vullnetarisht 146 njësi gjaku. Dita e njesisë u ndoq gjithashtu nga komandantët e komandave vartëse dhe njesisë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.



“Distanca e veprimit të këtyre sistemeve cdo herë vjen duke u rritur, ndërsa distanca e veprimit rritet, vecoria për të qëlluar me saktësi është dëshmuar edhe në kushtet më të vështira në terren. Testimi i këtyre donëve dhe deshmia e suksesit në teren janë arsye kryesore të këtij eksporti”. Me arritjen e këtyre doneve “Bayraktar-TB2” në Poloni do të realizohet edhe eksporti i parë nga Turqia në një vend antar të NATO-s dhe BE-se”.



## FORCAT E ARMATOSURA TURKE

# Avionët e parë luftarak pa pilot deri në vitin 2023

*Erdogan: “Turqia planifikon të fluturojë mbi qiell me avionin e saj luftarak pa pilot në vitin 2023”*

Presidenti Recep Tayyip Erdogan deklaroi më 24 maj 2021, se pas dy vitesh Turqia do të ketë avionët saj të pare luftarak pa pilot, një arritje e industrisë turke ushtarake. “Turqia planifikon të fluturojë mbi qiell me avionin e saj luftarak pa pilot në vitin 2023”, tha ai, në fjalën e tij të mbajtur në takimin e grupit të partisë së tij në Kuvendin e Madh Popullor të Turqisë. “Aktualisht, ne kemi 180 mjete ajrore pa pilot të tipit ‘Bayraktar’ që operojnë në katër vende të ndryshme së bashku me Turqinë”, deklaroi Erdogan.

Ndërkaq për dronët e armatosur që Turqia do t’i eksportoje në Poloni, Presidenti Erdogan tha: “Kjo marrëveshje është gjithashtu e rëndësishme për sa i përket shitjes së parë të Turqisë të dronëve të teknologjisë së lartë në NATO dhe në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian.”



### FORÇA DETARE TURKE NË DETIN EGJE DHE MESDHEUN LINDOR



### Zhvillohet stërvitja detare “Ujku i Detit 2021”

Forcat Detare Turke janë zhvendosur në Egje dhe Mesdheun Lindor për stërvitjen më të madhe të zhvilluar deri më tani. 132 anije, 10 nëndetëse, 43 aeroplanë, 28 helikopterë dhe 14 dronë po marrin pjesë në stërvitjen “Ujku i Detit 2021”, e cila po zhvillohet pas stërvitjes “Atdheu i Kaltër” të zhvilluar në muajin mars 2021.

Përveç forcave tokësore dhe ajrore, do të testohet edhe bashkëpunimi me 10 institucione publike dhe Gjysmëhënën e Kuqe Turke. Me këtë mbështetje, parashikohet që 25.500 trupa të jenë në terren. Stërvitja “Ujku i Detit 2021” përfshin elementë të gatishmërisë operative në nivelin strategjik. Aftësia e trupave dhe ekepeve për të shpëtuar personelin nga nëndetëset, lufta sipërfaqësore, lufta elektronike janë disa prej operacioneve. Në fazën e fundit të stërvitjes, 83 anije do të vizitohen 22 porte në Egje dhe Mesdheun Lindor. Ndryshe nga vitet e mëparshme, për shkak të masave të koronavirusit, anijet nuk do të jenë të hapura për qytetarët. Stërvitja në fjalë do të përfundojë më 5 qershor me ditën e vëzhguesve të dalluar në Mesdheun Lindor.

## KONTRATA DO TË PËRFUNDOJË DERI NË FUND TË VITIT 2024

# Turqia do ti shesë Polonisë, dron luftarak “Bayraktar TB-2” me vlerë 67 milion USD

*Droni luftarak është 6.5 metra i gjatë, ka një hapësirë 12 metra, kohëzgjatje fluturimi deri 27 orë, pesha dronit 650 kilogramë dhe shpejtësia maksimale rreth 220 km/orë*

Turqia arriti në marrëveshje me Poloninë, një vend anëtar e NATO-s dhe BE-së, për eksportin e dronëve të armatosur tip “Bayraktar TB-2”. Ministri i Mbrojtjes i Polonisë, Mariusz Blaszczak, tha se “Ne do të forcojmë ushtrinë me dronët “Bayraktar-TB2”. Ne biseduam mbi marrëveshjen për të blerë dronë të armatosur “Bayraktar-TB2” të paisur me 4 komplete, pra me municion antitank. Kompletet i parë do të dorëzohet ushtrisë së Polonisë brenda këtij viti. Është një armë e provuar dhe produktive për të parandaluar sulmuesin, ndërsa shtoi se marrëveshja përfshin edhe paketën logjistike dhe të trajnimit”.

Ozgur Tor, lektor në Universitetin e Stambollit thotë se: “Distanca e veprimit të këtyre sistemeve cdo herë vjen duke u rritur, ndërsa distanca e veprimit rritet, vecoria për të qëlluar me saktësi është dëshmuar edhe në kushtet më të vështira në terren. Testimi i këtyre donëve dhe deshmia e suksesit në teren janë arsye kryesore të këtij eksporti”. Me arritjen e këtyre doneve “Bayraktar-TB2” në Poloni do të realizohet edhe eksporti i parë nga Turqia në një vend antar të NATO-s dhe BE-se. “Ne kemi prodhuar një prej dronëve më të mirë në botë nga aspekti i kohëqëndrimit në ajër dhe sistemit të kordinimit të caqeve dhe ky është urimi i krenarise sonë”, thotë Ozgur Tor, lektor në Universitetin e Stambollit. Marrëveshja midis dy vendeve është nënshkruar më 24 maj 2021. “Usharët turq së shpejti do të fillojnë detyrën e “policies ajrore në rajonin e Baltikut dhe

në bazen Malbork”, tha ministri i Mbrojtjes i Polonisë, Mariusz Blaszczak.

“Kemi nënshkruar një kontratë për blerjen e katër grupeve të dronëve luftarakë. Grupet do të përbëhen nga 24 UAV taktike të pajisura me raketa anti-tank. Së bashku me armatimet, kemi blerë një paketë logjistike dhe stërvitore”, tha Mariusz Blaszczak, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare pas nënshkrimit të kontratës për blerjen e 4 grupeve UAV taktike “Bayraktar TB2” për Ushtrinë Polake. Kontrata mbulon shpërndarjen e 4 seteve UAV taktike “Bayraktar TB-2”. Secili grup



përbëhet nga 6 dronë të armatosur “Bayraktar TB-2”. Në total, Forcat e Armatosura polake do të marrin 24 UAV taktike. Kontrata gjithashtu përfshin shpërndarjen e, ndër të tjera, stacione të lëvizshme kontrolli, radarë SAR, simulatorë dhe një rezervë të pjesëve të këmbimit. Kontrata parashikon gjithashtu shpërndarjen e raketave të drejtuara me lazer MAM-L dhe MAM-C, të cilat do të mundësojnë kryerjen e spektrit të plotë të misioneve taktike në përputhje me caktimin operacional të sistemit dhe municionit stërvitor. Kontrata do të sigurojë një garanci 24-mujore, një paketë trajnimit dhe logjistike, si dhe transferimin e teknologjisë që siguron aftësinë për servisim dhe riparim, p.sh. motorët, stacionet e kontrollit në tokë dhe kamerat. Vlera e një kompleti “Bayraktar TB-2” ishte afërsisht 67 milion dollarë.

“Bayraktar TB-2” është një mjet ajror taktik taktik i aftë për të kryer mbikëqyrje dhe zbulim (ISR) dhe misionet luftarake duke përdorur raketa të drejtuara të kryera në katër pika pezullimi nën krahët. Bayraktar TB-2” është pajisur me një sistem avionik që mundëson ngritje, ulje dhe fluturime plotësisht autonome. Droni është 6.5 metra i gjatë dhe ka një hapësirë prej 12 metrash. Arrin një kohëzgjatje fluturimi deri në 27 orë. Pesha e ngritjes së dronit është 650 kilogramë, dhe shpejtësia maksimale është rreth 220 km/orë.

Grupi i parë do t’i dorëzohet Forcave të Armatosura polake deri në fund të vitit 2022. E gjithë kontrata do të përfundojë deri në fund të vitit 2024. Kontrata u nënshkrua më 24 maj 2021 gjatë vizitës së Presidentit Andrzej Duda dhe Ministrit Mariusz Blaszczak në Turqi.

# Në kuadrin e 80 vjetorit të varjes në litar nga fashizmi të Vasil Laçi, më

## Plumba mbi perandorin

*Rezistenca kishte nisur në Romë, më 13 maj 1939, kur rreth katërqind studentë shqiptarë që studionin në shkollat dhe akademitë ushtarake italiane, kishin refuzuar betimin ushtarak Italian*



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

### Atdhetari antifashist

Pasuria më e madhe e një kombi është historia e tij, e njerëzve të vet që e bëjnë dhe e krijojnë në vazhdim. 17 maj 1941 na bën të reflektojmë, por dhe të kuptojmë sa themeltare në histori është bashkëkombësi që bën emër duke na u imponuar me modesti, nga shqiptar i thjeshtë dhe me shpirtin e tij, bëhet hero. Vasil Laçi qëllon me pesë plumba perandorin italian Viktor Emanueli III. Ishte një djalosh rreth 19 vjeçar. Ngjarja e dukshme, tepër e rrallë në biografinë tonë kombëtare, por dhe në Ballkan, ndodhi në kryeqytet, në Rrugën e Durrësit, në Tiranë. Në këtë rrugë është e vështirë të dallosh një basoreliev të vogël, që tregon një histori kombëtare. Këtë vepër kujtose e kanë bërë komunistët, sistemi shoqëror që kishim nga vitet 1944-1990. Në "Fjalori enciklopedik shqiptar" të vitit 1985 shkruhej se ishte "i ri patriot antifashist", ndërsa në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" të vitit 2008, përshkruhet si "atdhetar antifashist".

Atentatori Vasil Laçi mund të themi pa frikë se është më i famshëm i Ballkanit në Luftën e Dytë Botërore. Kur i riu Vasil Laçi, ngriti dorë dhe qëllon më 17 maj 1941, mbi "mbretin-perandor", fashizmi ishte shndërruar në fuqi globale dhe tepër të pathyeshme. Hitleri dhe Musolin kishin vënë nën sundim pothuaj gjithë hapësirën e Evropës. Në këtë kohë këto dy fuqi kishin përfunduar dhe pushtimin e të gjithë gadishullit të Ballkanit. Fundi i prillit 1941 kishte përfunduar dhe pushtimi i Jugosllavisë dhe i Greqisë. Britania e Madhe nuk po e zotëronte dot Ballkanin, ndërsa Bashkimi Sovjetik ishte i vetëm në fillimin e kësaj lufte. Dhe ky vend që zotëronte një territor sa një e gjashta e botës, u sulmua pak ditë më pas nga jehona e pesë të shtënave të revolverit të Vasil Laçi. Më 22 qershor 1941, Hitleri nisi sulmin kundër Bashkimit Sovjetik, duke thyer dhe paktin e molotovi me pëlqimin e Hitlerit dhe të Stalinit.

### Fillimi i rezistencës popullore

Kur i riu shqiptar, patrioti Vasil Laçi kreu aktin e rrallë guximtar, komunistët në vend ishin një pakicë



numerike. Ata nuk kishin ndonjë ndikim në popull, si në planin ideologjik, politik, por dhe në aksione konkrete kundër pushtuesit fashist. Ndoshta kjo dhe për shkak të detyrimit që të respektonin traktatin Ribentrop-Molotov për bashkëpunim mes Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik, duke qëndruar të tërhequr, por rezistenca e madhe kombëtare kishte filluar.

Me heroizmin e tij si shqiptar dhe patriot Vasil Laçi më 17 majit 1941 proklamoi rezistencë popullore, shpërthimin e urrejtjes kundër fashizmit dhe pushtuesit Italian. Kjo rezistencë kishte nisur në Romë, më 13 maj 1939, kur rreth katërqind studentë shqiptarë që studionin në shkollat dhe akademitë ushtarake italiane, kishin refuzuar betimin ushtarak Italian. Nisi kundër tyre një represion dhe gjyqe të heshtura, deri në burgime të studentëve. Studentëve ushtarakë shqiptarë ky veprim ju kushtoi 16 të burgosur dhe të internuar në ishullin Ventotene.

Deri në momentin e 17 majit 1941, kur i riu Vasil Laçi shtiu me plumb mbi perandorin, nga pushtuesit italianë ishin bërë rreth 1130 bastisje banesash, si dhe 21.131 kontrole të personave, ku në kampet e përqendrimit të Italisë numëroheshin rreth 5279 patriotë shqiptarë. Akti i të riut shqiptar që qëllon mbi perandorin ishte i jashtëzakonshëm dhe me rëndësi si për Shqipërinë, për Ballkanin, por dhe për historinë e Luftës së Dytë Botërore. Ky akt

deri diku në atë kohë ngeli në harresë. Tërë Ballkani ishte nën pushtim dhe për aktin heroik të të riut shqiptar që ishte sinjal për rezistencë nuk u shkrua asnjë rresht për çfarë ndodhi në mes të kryeqytetit shqiptar. Greqia ishte nën pushtim. Edhe në Itali, çensura ishte në kulm, si dhe në Tiranë. Heshtja e pushtuesve fashistë ishte pasojë e asaj që prej 7 prillit 1939, fashistët italianë shqiptarët i kishin paraqitur në opinionin botëror se ishin pritur me tufa me lule. Plumbat e Vasil Laçi flisnin për të kundërtën në Shqipëri.

### Madhështia e aktit heroic

Vasil Laçi u arrestua menjëherë. E torturuan egërsisht për dhjetë ditë me radhë. Në këto ditë fashistët nuk i kursyen të gjitha llojet e shpifjeve, i vendosën emër tjetër dhe origjinën ja bënë greko-maqedonase. Vasil Laçi si patriot shqiptar u përpoq të shtinte mbi mbretin e Italisë dhe uzurpatorin e fronit të Shqipërisë, Viktor Emanueli III, si dhe mbi Shefqet Bej Vërlacin, Kryeministër i Shqipërisë, pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste.

Vasili kishte lindur në fshatin Piqeras në Shqipërinë jugore afër qytetit të Sarandës në vitin 1922. Fëmijërinë e tij e kaloi në Piqeras, ku dhe studio në shkollë fillore. Në 1939 gjendet në Tiranë, për t'u punësuar ku të mundëte.

Viktor Emanueli III kishte planifikuar një vizitë në Shqipëri dhe

pasi mori garanci nga policia fashiste italiane në Tiranë, nisi vizitën. Vasili e merr vesh për vizitën e Viktor Emanuelit në Shqipëri më 2 maj 1941. Ai mori hua një pistoletë Beretta nga Pëllumb Koka, një tjetër patriot shqiptar, ku dhe ishte strehuar e punësuar. 19-vjeçari Vasil Laçi, ditën e largimit të perandorit, u vesh me një kostum kombëtar shqiptar dhe u përgatit shpirtërisht për të qëlluar mbi makinën ku ishte Viktor Emanueli III dhe Shefqet Bej Vërlacin, Kryeministër i Shqipërisë. Pritej nga çasti në çast të kalonte Perandori. Filloi kortezhi i veturave. Sovrani, në një veturë të hapur, kalonte përmes batalioneve të këmbësorisë, të kalorësisë, të formacioneve fashiste të ndarë në tre kolona në të dyja anët e rrugëve, ndërsa sipër fluturonin skuadriljet e aeroplanëve. Në këtë atmosferë pasigurie e frike, rrethuar kudo me helmata dhe armë, i riu patriot Vasil Laçi, hyri në mes të turmës dhe priti rastin e volitshëm. Ai ngriti dorën mbi helmata dhe grykët e armëve fashiste dhe qëllon pesë herë në drejtim të Perandorit.

### E përcolli me plumb perandorin

Populli shqiptar me dorën e njërit prej bijve të tij, e përcolli me plumb Perandorin Viktor Emanuelin III. Perandori kishte mbaruar vizitën e tij shtatëditore në Shqipëri dhe po largohej në drejtim të aeroportit të Laprakës, në Rrugën e Durrësit, u qëllua nga djaloshi 19-vjeçar,

me origjinë nga fshati Piqeras i Sarandës, i cili quhej Vasil Laçi. Ndërsa Mbreti Viktor Emanueli III shpëtoi pa u vrarë, vetëm në saj të agjentëve të policisë së fshehtë italiane që atë ditë ndodheshin në gatishmëri të lartë dhe ia kapën menjëherë revolverin djaloshit, por plumbat e pistoletës së tij fshikulluan lehtë Kryeministrin shqiptar Shefqet Vërlaci, që ndodhej në makinë me Mbretin e Italisë. Ai realizoi pesë të shtëna në drejtim të tyre, por pa mundur të vrasë perandorin. Qeveria fashiste italiane sulmin e tij e trajtoi për çështje ekonomike dhe se ai veprim kishte të bënte me Shefqet Bej Vërlacin.

### Zuri vend nderi

Regjimi komunist atentatin e djaloshit Vasil Laçi ndaj Mbretit të Italisë, Viktor Emanueli III, nuk e përvetësoi dhe nuk e paraqiti si veprim të komunistëve, por ai zuri vend nderi në altarin e lirisë si patriot dhe atdhetar i lavdishëm. Në librin Yje të Pashuar, për këtë ngjarje, thuhet fjalët e Vasil Laçi se "E bëra vetë, për Shqipërinë / Rroftë Shqipëria e Lirë / Poshtë fashizmi". Atentati i djaloshit shqiptar, që qëllon Viktor Emanuelin III në rrugën e Durrësit, ishte fillimi i një kryengritjeje të madhe që po përgatitej.

Plot 80 vjet më parë, më 27 maj të vitit 1941, do të varej në litar sepse guxoi dhe shtiu pesë herë me plumba mbi Mbretin e Italisë dhe Perandorin e Etiopisë, Viktor Emanueli III, të pagëzuar edhe si Mbret i Shqipërisë pas dorëzimit të Kurorës së Skënderbeut.

Sistemi komunist këtij luftëtari dhe patrioti i kushtoi: një monument në Tiranë për të nderuar veprën e tij, një libër, një film "Plumba mbi Perandorin", vendosje të emrit të tij në rrugë dhe shkolla të vendit, e shpalli Dëshmor të Atdheut, si dhe e vlerësoi me titullin e lartë "Hero i Popullit". Ndërsa në vitin 2019 Presidenti i Republikës e ka dekoruar pas vdekjes, si një prej heronjve më frymëzues të rezistencës antifashiste, Vasil Laçin, me dekoratën e lartë të "Flamurit Kombëtar".

Vasil Laçi me krismat e tij zgjoi fort ndërgjegjen kombëtare të rinisë shqiptare dhe të popullit shqiptar, duke u treguar se rruga e lirisë kërkonte përballje me pushtuesin dhe vendosmëri për sakrificat më sublime. Kështu Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është një nga epopetë më të ndritura të popullit shqiptar në betejat për liri, çlirim, pavarësi dhe dinjitet kombëtar.



## "DEFENDER EUROPE 21"

# Për herë të parë në Shqipëri artileria e rëndë amerikane

*Në Bazën Ajrore të Kuçovës do të instalohet Sistemi amerikan i mbrojtjes ajrore Patriot - një sistem i mbrojtjes raketore tokë-ajër kundër raketave balistike*

